

## SHQIPËRI - SHBA, PARTNERITET NË FUSHËN E ENERGJISË

Partneriteti ekonomik në fushën e energjisë mes SHBA dhe Shqipërisë, si dhe siguria energjetike ishin në fokus të takimit që ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku zhvilloi në Uashington me Sekretarin Amerikan të Energjisë, Dan Brouillette. Penetrimi i gazit të lëngshëm në tregun shqiptar si dhe përdorimi i tij për vënien në funksion të TEC Vlorë, ndërtimi i depozitave apo dhe i një terminali për LNG në të ardhmen, që do t'a bënte Shqipërinë një pike shpërndarje për sasitë e eksportuara të LNG nga SHBA u diskutuan gjerësisht në takim.

## TRYEZË PËR GAZIN E LËNGSHËM NATYROR

MIE në partneritet me Departamentin Amerikan të Energjisë organizuan në Tiranë një tryezë mbi hulumtimin e "Potencialit të penetrimit dhe aplikimit të Gazit të Lëngshëm Natyror në Europën Qendrore dhe Lindore". Të pranishëm ishin Ministrja Balluku, Ambasadorja, Yuri Kim, Ndihmës Sekretari për Hidrokarburet në Departamentin Amerikan të Energjisë, Steven Winberg, drejtues institucionesh si dhe ekspertë amerikanë dhe shqiptarë në fushën e gazit të lëngshëm.

## ZHVILLIMI I TREGUT TË TELE- KOMUNIKACIONIT

Ministrja Belinda Balluku mori pjesë në aktivitetin, "One Vision", organizuar nga kompania Telekom Albania, e cila zyrtarizoi marrëveshjen me kompaninë Ericsson për modernizimin e rrjetit të transmetimit të saj. Ministrja tha në fjalën e saj se Qeveria Shqiptare mbështet dhe inkurajon zhvillimin e sektorit të telekomunikacionit, si dhe është e gatshme për t'u përballur me sfidat që ofron zhvillimi i teknologjisë.

## MIRËMBAJTJA DIMËRORE E RRUGËVE

Pavarësisht kushteve të vështira, të shkaktuara nga moti i keq, që përfshiu vendin gjatë kësaj jave, të gjitha akset rrugore kanë qenë të aksesueshme për të gjithë përdoruesit e mjeteve. Grupet e punës së ARRSH-së dhe kompanitë kontraktore të mirëmbajtjes së rrugëve kanë qenë në gatishmëri të plotë, duke ndërhyrë në kohë për pastrimin e të gjitha akseve nacionale.

## INVESTIMI NË HEC FIERZË

Ka përfunduar investimi për mbrojtjen e anës së majtë të biefit të sipërm të digës së Fierzës dhe ndërtimi i vend parkimit të mjeteve lundruese në HEC Fierzë. Ky investim zhvillon këtë aset jo vetëm nga ana teknike, për të cilën është projektuar dhe realizuar, por dhe për të nxitur turizmin malor si dhe për të promovuar vlerat e Liqenit të Fierzës.

## MIRËMBAJTJA DIMËRORE E AKSEVE RRUGORE

Këshilli Teknik, AKUM shqyrtoi dhe miratoi projektin për rrjetin e jashtëm të ujësjellësit të Peshkopisë. Projekti parashikon ndërtimin e 12 km linjë e re dhe rikonstruksion në disa objekte të rrjetit. Ky investim garanton furnizim 24 orë ujë të pijshëm dhe me cilësi për afro 22 mijë banorë të Peshkopisë dhe disa fshatrave përreth.